



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
KRYESIA

Prot 92

Tiranë, më ²⁶__1.2024

Vendim nr. 13.1.2024

Për thirrjen e mledhjes së Asamblesë së Akademisë së Shkencave
të Shqipërisë

Kryesia e Akademisë së Shkencave, në mbledhjen e saj të datës
26.1.2024, bazuar në nenin 8, pika 3, të Ligjit 53/2019 Për Akademinë e
Shkencave në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar si dhe nenin 26, 28 dhe
29 të Statutit të saj,

Vendosi:

1. Të thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë më datë 23 shkurt 2024, në orën ⁰⁹__ në sallën “Aleks Buda” me rend dite bashkëngjitur.
2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohen: sekretari shkencor i ASH, kryetarët e seksioneve, drejtuesit e komisioneve dhe njësive, drejtuesit e instituteve dhe qendrave të albanologjisë, përgjegjësit e sektorëve dhe kancelari.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akad. Skënder GJINUSHI
KRYETAR





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
KRYESIA

Tiranë, më 26.1.2024

Rend dite

Për mbledhjen e Asamblesë

Referuar nenit 28, pika 1, 2 dhe 3 të Statutit, mbledhja e Asamblesë së Akademisë së Shkencave do të mbahet më datë 23 shkurt 2024, ora 11.00 me këtë rend dite:

1. Paraqitje e raportit përmblidhës së veprimtarisë vjetore të Akademisë së Shkencave për vitin 2023 dhe programi e prioritet e veprimtarisë për vitin 2024.
2. Për disa shtesa dhe ndryshime në Statut sipas vendimit të Kryesisë nr. 12, datë 23.1.2024 (bashkëngjitur):
 - ndryshimi i Aneksit 4 “Komisionet dhe emërtimi i tyre”;
 - reflektimi i ndryshimeve të bëra në ligjin 53/2019 me ligjin 69/2023, datë 21.7.2023 i Kuvendit të Shqipërisë *Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”*;
 - reflektimi i ndryshimeve që vijnë me përfshirjen e Kreut VI *Institutet dhe qendrat kërkimore të përhershme*, miratuar me vendimin qarkullues të Asamblesë nr. 1, datë 9.1.2024;
3. Njohja e Asamblesë me vendimin e Kryesisë nr. 11, datë 23.1.2024 “Për fillim procedure për kandidatët që kanë aplikuar për avancim në titullin *akademik*”.
4. Çështje që lidhen me ecurinë për ngritjen e Akademisë së të Rinjve pranë ASHSH.